

Qasja në drejtësi për dhunën online: Ligji dhe shpërndarja e fotografive intime të paautorizuara në Kosovë

Nëntor 2023



Qasja në drejtësi për dhunën online: Ligji dhe shpërndarja e fotografive intime të paautorizuara në Kosovë

Nëntor 2023

Qasja në drejtësi për dhunën online: Ligji dhe shpërndarja e fotografive intime të paautorizuara në Kosovë

Ky publikim është pjesë e projektit "Qeverisja e Mirë në Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor" të DCAF - Qendrës të Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë, i mbështetur nga FCSO - Zyra e Jashtme për Komonvelt dhe Zhvillim e Mbretërisë së Bashkuar.

Pikëpamjet, gjetjet dhe opinionet në këtë publikim janë vetëm ato të autorëve dhe si të tilla nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e DCAF.

Përgatitur nga: **Lulzim Peci, Valdrin Ukshini dhe Viola Kastrati**

Copyright © 2023, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

www.kipred.org

Hyrje

Bërja dhe shpërndarja e fotografive intime pa miratimin e personit nuk është asgjë e re, dhe kjo ka ndodhur që nga koha kur është zbuluar aparati fotografik. Mirëpo përparimet në teknologjinë kompjuterike – Interneti dhe programet për kërkim, rrjetet sociale, smartfonat dhe aplikacionet mobile, si dhe inteligjenca artificiale – shpërndarjen e fotografive intime të paautorizuara (FIPA), e kanë bërë çështje të shqetësimit, për një numër potencialisht të madh të njerëzve, anembanë botës.¹ Dhe ndërkohë që çdonjëri shtet rastet që kanë të bëjnë me FIPA i trajton në harmoni me kornizën dhe institucionet e veta ligjore, shumë nga viktimat, kur kërkojnë drejtësi, përballen me sfida personale dhe ligjore që zakonisht burojnë nga normat shoqërore lokale.² Këto i përfshijnë efektet e ndryshme psikologjike të cilat mund të rezultojnë nga abuzimi me FIPA.³

Në Kosovë, autoritetet shtetërore janë të obliguara që t'u përmbahen dispozitave të Konventës së Stambollit.⁴ Këto dispozita kërkojnë nga palët e Konventës që të ndër marrin masa thelbësore për të promovuar ndryshime në modelet shoqërore dhe kulturore, të grave dhe të burrave, për t'i eliminuar paragjykimet, zakonet, traditat, dhe praktikatat e tjera të bazuara në konceptin e inferioritetit të grave apo të roleve gjinore stereotipike. Për më tepër, veprimet e dhunës të përfshira në fushëveprimin e kësaj Konvente nuk mund të justifikohen duke u bazuar në kulturë, fe, tradita, apo në "nder."⁵ Dispozitat e Konventës po ashtu i obligojnë shtetet të marrin masa për të siguruar që institucionet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet gjyqësore të jenë të aftësuarat siç duhet për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht aktet e dhunës kundër grave, përfshirë edhe rastet që kanë të bëjnë me abuzimin me FIPA.⁶

Ky hulumtim shqyrton çështjen e abuzimit me FIPA në Kosovë përmes prizmit të normave ligjore dhe shoqërore. Fillimisht shqyrtohet korniza ligjore relevante, dhe këtu identifikohen disa mangësi. Më pas analizohen 55 aktgjykime të shpallura nga gjykatat kosovare në rastet që kanë përfshirë FIPA. Këto shtrihen që nga rasti i parë i regjistruar, në 2016, e deri te rasti fundit në vitin 2022. Kjo vijohet nga një diskutim i mënyrave në të cilat normat patriarkale të përhapura në Kosovë e pengojnë trajtimin e drejtë të viktimave të abuzimit me FIPA nga ana e organeve ligj-zbatuese, e që i kontribuon shqetësimeve shoqërore dhe psikologjike që këto viktimat i përjetojnë. Së fundi, përmbledhen gjetjet parësore të këtij hulumtimi, dhe parashtrohen rekomandime të veçanta që duhet të merren parasysh nga institucionet kosovare.

1 Nicola Henry, et al., *Image-Based Sexual Abuse: A Study on the Causes and Consequences of Non-Consensual Nude or Sexual Imagery [Abuzimi Seksual i Bazuar në Fotografi: Studim i Shkaqeve dhe Pasojave të Fotografimeve Lakuriqe apo Seksuale të Paautorizuara]* (Routledge, 2021), 1–2. Instituti Evropian për Barazimin Gjinor, Abuzimi me Fotografitë Intime të Paautorizuara (FIPA) e përkufizon si shpërndarje apo kërcënim të shpërndarjes së "fotografive/ videove intime, private dhe/ose të manipuluar... pa miratimin e personit," dhe vëren se FIPA shpesh herë bashkekziston me dhunën e partnerëve intimë. Në rastet e tilla është e shpeshtë "pornografia hakmarrëse," dhe kjo përfshin përpjekjen e "turpërimit dhe poshtërimit publik të viktimës." Shih: European Institute for Gender Equality, "Cyber Violence against Women and Girls: Key Terms and Concepts" ["Dhuna Kibernetike kundër Grave dhe Vajzave: Shprehjet dhe Konceptet Kyçe"], 2022.

2 Normat shoqërore janë rregulla të pashkruara që e udhëheqin sjelljen njerëzore dhe përcaktojnë veprimet e pranueshme dhe të duhura brenda një komuniteti. Këto norma janë të bazuara në atë që njerëzit bëjnë, çfarë ata mendojnë se të tjerët bëjnë, dhe çfarë ata besojnë se të tjerët miratojnë dhe presin që ata ta bëjnë. Në këtë mënyrë normat shoqërore rezultojnë nga ndërveprimi midis sjelljes, besimeve, dhe pritjeve, dhe këto mësohen dhe integrohen nga një moshë shumë e hershme, zakonisht gjatë foshnjërisë. Këto zbatohen përmes sanksioneve shoqërore (ndëshkimeve) për mos-zbatim, dhe përfitimeve shoqërore (shpërblimeve) për zbatim. Kur njerëzit u përshtaten normave shoqërore, ata presin të shpërblehen; dhe kur ata i shkelin normat, ata presin të ndëshkohen. Normat shoqërore ekzistojnë kur njerëzit sillen në mënyra të caktuara, qoftë për shkak se besojnë që njerëzit të tjerë si ta e ushtrojnë atë sjellje (normat deskriptive-përshkruese), qoftë për shkak se besojnë se ata të cilët janë të rëndësishëm për ta e miratojnë atë sjellje (normat injunktive-urdhëruese). Shih: UNICEF, "Defining Social Norms and Related Concepts," ["Përkufizimi i Normave Shoqërore dhe i Koncepteve të Ndërlidhura"], November 2021.

3 Këto mund të përfshijnë simptomat e çrregullimeve depresive ose të ankthit, apo të çrregullimeve të stresit post-traumatik. Shih: Vaslieia Karasava, "Personality, Attitudinal, and Demographic Predictors of Non-consensual Dissemination of Intimate Images," ["Parashikuesit e Personalitetit, të Qëndrimit, dhe Demografikë, të Përhapjes së Paautorizuar të Fotografive Intime"], *Journal of Interpersonal Violence* 37, no. 22-23 (2021): NP19265–NP19289.

4 Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës përcakton që Konventa e Stambollit është drejtpërdrejt e zbatueshme në vend.

5 Këshilli i Europës, Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence [Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës familjare], CETS 210, 11 maj 2005, Neni 12(1) dhe (5). Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/168008482e>.

6 Ibid., Neni 15.

Analiza e kornizës ligjore në Kosovë

Duhet të nënvizohet se abuzimi me FIPA është një vepër penale, si dhe shkelje e të drejtës për privatësi.⁷ Në Kosovë, e drejta për privatësi është e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, i cili përcakton se “Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera,” dhe se “Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, e cila duhet të rregullohet me ligj.”⁸ Mirëpo, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk përmban dispozita të veçanta që kanë të bëjnë me FIPA.⁹

Është problematike që veprat penale lidhur me FIPA nuk janë të rregulluara në mënyrë eksplicite me Kodin Penal të Kosovës, meqë kjo ndikon se a do të raportohen, hetohen dhe gjykohen këto vepra, dhe si do të bëhet kjo. Neni 202 i Kodit Penal e trajton në mënyrë të përgjithshme çështjen e abuzimit me FIPA, duke iu referuar fotografimit dhe inçizimit të paautorizuar, dhe shpërndarjes së paautorizuar të fotografive. Mangësia kryesore e këtij neni është që nuk e përcakton si mund të mirët, refuzohet, apo të tërhiqet “autorizimi” (d.m.th. miratimi). Paragrafi 1 i këtij neni thekson që, “Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, inçizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër inçizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej (1) deri në (3) vjet.” Dhe paragrafi 2 e zbaton të njëjtin kriter për shpërndarje, duke theksuar se “Kushdo që pa autorizim ia kalon, shfaq apo i jep qasje personit të tretë në fotografinë, filmin, videokasetën apo ndonjë inçizim tjetër të marrë në shkelje të këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.”¹⁰

Për më tepër, për t’u gjykuar në bazë të nenit 202, autorët duhet që fotografitë intime në fjalë t’i marrin apo t’i inçizojnë personalisht, meqë kjo dispozitë nuk është e zbatueshme për rastet kur këto fotografi merren përmes mjeteve të tjera apo palës së tretë. Varësisht nga ajo se si autori i veprës i siguron FIPA-t, neni 199 mund të jetë relevant, meqë ky i saktëson sanksionet (dënim me gjobë, apo burgim deri në një vit) nëse të dhënat sigurohen përmes futjes dhe ndërhyrjes në sistemet kompjuterike të personit tjetër. Mirëpo zbatueshmëria e Nenit 199 është e kufizuar vetëm në ndërhyrjen kriminale dhe në futjen në sistemet kompjuterike, dhe nuk ka të bëjë me smartfona dhe teknologji të tjera komunikuese.

Në rastet kur bëhen kërcënime për t’i shpërndarë apo publikuar FIPA-t, baza ligjore për ndjekje penale në Kosovë është edhe më e kufizuar. Meqë nuk ka dispozita të Kodit Penal që zbatohen në mënyrë të veçantë për rastet që përfshijnë FIPA, kryesit që kërcënojnë me publikimin dhe shpërndarjen e FIPA përballen me dënim me gjobë ose deri në gjashtë (6) muaj burgim.¹¹ Këto sanksione nuk duket se i kanë demotivuar autorët e veprave. Mirëpo, në rastet e akuzuara si shantazh – kur autori i veprës synon të arrijë përfitime materiale nga shpërndarja e FIPA-s – Kodi përfshin dispozita që në mënyrë implicite e adresojnë dëmtimin e abuzimit me FIPA duke iu referuar dëmtimeve të nderit dhe të autoritetit. Aktet e shantazhit janë të rregulluara me nenin 329 të Kodit Penal, që e përcakton dënimin me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muajsh e deri në pesë (5) vjet.¹²

7 Meghan Sali, “Intimate Images and Authors’ Rights: Non-Consensual Disclosure and the Copyright Disconnect” [“Fotografitë Intime dhe të Drejtat e Autorit: Zbulimi i Paautorizuar dhe Shkëputja e Copyright-it”], *Canadian Journal of Law and Technology* 19, no. 2 (2021): 333–369.

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008, Neni 36.

9 Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-082, 25 shkurt 2019.


10 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 202.

11 Ibid., Neni 181.

12 Ibid., Neni 329.

Duhet theksuar se çështja e abuzimeve të FIPA nuk adresohet drejtpërdrejtë as nga legjislacioni i BE-së. Ndërkohë që Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme parasheh rregulla të përpikta për përpunimin e të dhënave personale, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale të ndjeshme, kjo nuk i përcakton format e dhunës kibernetike; mirëpo, ofron mbrojtje për viktimat e dhunës kibernetike dhe mundëson dhënien e sanksioneve kundër individëve përgjegjës për ndarjen e përmbajtjeve të paautorizuara dhe kundër atyre që publikojnë përmbajtje të tilla.¹³ Prandaj, disa shtete anëtare të BE-së kanë përvetësuar ligje që abuzimet me FIPA i kriminalizojnë në mënyrë eksplicite.

Shembulli më domethënës për këtë është Irlanda, e cila miratoi Aktin e vitit 2020 për Ngacmime, Komunikime Dëmtuese dhe Veprat e Ndërlidhura Penale (Harassment, Harmful Communications and Related Offences Act), i cili fotografinë intime e përkufizon si çdo përfaqësim vizual, i bërë nga çfarëdo filmi apo mjete digjital, i cili tregon, apo pretendon të tregojë, organet gjenitale të personit, vithet, apo rajonin anal, dhe, në rastin e femrës, gjinjte e saj; mbulimin me të brendshme të organeve gjenitale të personit, të vitheve, apo të rajonit anal, dhe, në rastin e femrës, të gjinjve të saj; të personit që është lakuriq; apo të personit të angazhuar në aktivitet seksual.¹⁴ Akti e kriminalizon inçizimin, shpërndarjen, publikimin, apo kërcënimin për të shpërndarë apo publikuar fotografi intime pa miratimin e personit, dhe e sanksionon këtë veprë penale me dënim prej shtatë (7) vitesh burgim dhe/ose me një gjobë të pakufishme.¹⁵ Është e rëndësishme që ky ligj zbatohet pavarësisht nga ajo se a janë bërë fotografitë apo inçizimet në fjalë personalisht nga autori i krimit, apo janë dërguar nga viktimat, apo janë siguruar përmes mënyrave të tjera; është shpërndarja, apo kërcënimi për t'i shpërndarë FIPA-t, ajo që është e dënueshme. Ky po ashtu e merr parasysh dëmtimin psikologjik të viktimës, që shënon një hap të madh përpara në legjislacionin në këtë fushë. Në këtë mënyrë, Akti për Ngacmime, Komunikime të Dëmshme dhe Veprat e Ndërlidhura Penale i Irlandës mund të shërbejë si një model i vlefshëm për vendet e tjera që janë duke u përpjekur për ta siguruar një mbrojtje të mjaftueshme të viktimave dhe dënime të duhura për autorët e veprave në rastet e abuzimeve me FIPA.

▀▀ Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, inçizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër inçizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej (1) deri në (3) vjet.” 

¹³ European Institute for Gender Equality [Instituti Evropian për Barazi Gjinore], *Combating Cyber Violence against Women and Girls [Luftimi i Dhunës Kibernetike kundër Grave dhe Vajzave]* (Vilnius, 2022), 20.

¹⁴ Qeveria e Irlandës, Harassment, Harmful Communications and Related Offences Act 2020 [Akti i vitit 2020 për Ngacmime, Komunikime Dëmtuese dhe Veprat e Ndërlidhura Penale], Irish Status Book No. 32 of 2020, 28 December 2020.

¹⁵ Ibid.

Analiza e praktikës gjyqësore në Kosovë

Aktgjykimi i parë në një rast që përfshinte FIPA është nxjerrë nga gjyqësori i Kosovës në vitin 2016. Këtu janë analizuar 55 aktgjykimet të cilat janë nxjerrë për këto raste në Kosovë, që nga ajo kohë, e deri në aktgjykimin e fundit të nxjerrë në vitin 2022, për të analizuar dhe përcaktuar si zbatohet në praktikë ligji në rastet me FIPA në Kosovë.¹⁶ Sipas Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, këto raste gjykohen sipas nenit 202 të Kodit Penal.¹⁷

Informatat e siguruar nga Policia e Kosovës tregojnë se vetëm në vitin 2022, Gjykatave Themelore u janë parashtruar 45 raste të shpërndarjes së FIPA, bazuar në akuzat që janë nxjerrë sipas nenit 202.¹⁸ Në ndërkohë, në vitin 2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka regjistruar 32 raste të shkeljeve të nenit 202, 24 nga të cilat janë zgjidhur. Mirëpo, baza online e aktgjykimeve, e Këshillit tregon se vetëm 3 nga 14 aktgjykimet e shpallura në vitin 2022 ishin raste që përfshinin shpërndarje të FIPA, meqë aktgjykimet e tjera ku ishte zbatuar neni 202 nuk kanë përfshirë FIPA.¹⁹ Për më tepër, ky hulumtim ka gjetur se rastet FIPA nuk adresohen çdo herë përmes nenit 202, por, edhe përmes dispozitave të tjera të Kodit Penal. Prandaj, aktgjykimet e analizuar këtu janë të kategorizuara në dy grupe: shpërndarja e FIPA (28 raste), dhe posedimi i FIPA të përdorura për qëllime të tjera kriminale (27 raste). Më tutje, ky seksion do ta adresojë edhe çështjen e kompensimit të dëmeve emocionale dhe psikologjike, si dhe të dëmeve të tjera.

Shpërndarja e fotografive intime të paautorizuara

Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka publikuar listën e 28 aktgjykimeve që përfshijnë shpërndarjen e FIPA (shih Tabelën 1). Gjykatat në Prishtinë dhe në Pejë e kanë pasur numrin më të madh të këtyre rasteve (nga 6 çdonjëra), pasuar nga Prizreni (5), Ferizaji e Gjakova (nga 4 çdonjëra), dhe Gjiçani (3). Gjykatat e tjera, në nivelet themelore apo të apelit, nuk kanë shpallur aktgjykime lidhur me shpërndarjen e FIPA.

¹⁶ Informatat për rastet janë nxjerrë nga baza online e aktgjykimeve e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Shih Aneksin 1 për listën e rasteve të analizuar për këtë hulumtim.

¹⁷ Komunikim përmes e-mailit me Policinë e Kosovës, 31 janar 2023; dhe komunikim përmes e-mailit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, 2 shkurt 2023.

¹⁸ Policia e Kosovës, komunikim përmes e-mailit, 31 janar 2023.

¹⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, komunikim përmes e-mailit, 2 shkurt 2023.

Tabela 1. Aktgjykimet për rastet që përfshijnë shpërndarjen e FIPA, sipas vitit

Viti	Numri i aktgjykimeve
2018	1
2019	11
2020	5
2021	5
2022	6
TOTALI	28

Aktgjykimi më i hershëm në një rast ku është gjykuar shpërndarja e FIPA në Kosovë është marrë në vitin 2018, dhe 2019-shi e shënon vitin me numrin më të lartë të këtyre aktgjykimeve (11). Në 28 rastet e tilla të gjykuara në Kosovë, kanë qenë 29 viktima dhe 29 autorë të krimeve, të ndarë përmes vijave të qarta gjinore. Me fjalë të tjera, pothuaj të gjitha viktimat (28) kanë qenë gra, përfshirë edhe tri vajza të mitura, dhe pothuajse të gjithë autorët e krimeve (28) kanë qenë burra, ndërkohë që paditësi i vetëm burrë ishte viktimë e autores së krimit që ishte grua.

Është e qartë që gratë kanë gjasat më të mëdha për të qenë viktima të krimeve që përfshijnë shpërndarje të FIPA.²⁰ Po ashtu, me përjashtim të dy rasteve, rezulton që autorët e krimeve kanë pasur ndonjë lloj lidhje paraprake apo aktuale me viktimat e tyre – qoftë marrëdhënie paraprake intime (12), martesë paraprake (6), martesë aktuale (3), fejesa paraprake (2); apo ndonjë lidhje si çift (1) apo të jetës në të njëjtën lagje (1). Motivet e shprehura të autorëve të krimeve kanë ndryshuar, ku disa kanë shprehur të ribashkohen me viktimën, disa kanë kërkuar përfitime materiale, disa kanë synuar të ngacmojnë dhe frikësojnë, dhe disa kanë synuar ta dëmtojnë reputacionin dhe nderin e viktimës. Në një numër rastesh, shpërndarja e FIPA është nxitur nga një mospajtim midis viktimës dhe autorit të veprës.²¹

Ndërkohë që paragrafi 2 i nenit 202 të Kodit Penal të Kosovës përcakton bazën ligjore për adresimin e rasteve të shpërndarjes së FIPA, këto raste nganjëherë gjykohen nën paragrafin 1 të të njëjtit nen – i cili e adreson veprimin e bërjes së fotografive intime por jo edhe shpërndarjen e tyre – apo edhe në raste më të shpeshta rastet gjykohen në bazë të neneve tjera të Kodit Penal. Zbatimi i neneve të tjera lë të kuptohet se disa viktima nuk kanë marrë trajtim të drejtë nga gjykatat apo drejtësi të plotë sipas ligjit, dhe se barra ligjore për disa nga autorët e krimeve është ulur. Këto aktakuza kanë përfshirë: cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike (6 raste), ngacmimi (6 raste), fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara (5 raste), hyrja në sistemet kompjuterike (3 raste), dhunën familjare (3 raste), shantazhi (2 raste), dhe ngacmimin seksual (1 rast).

²⁰ Ibid.

²¹ Ibid.

Tabela 2. Numri i rasteve të shpërndarjes së FIPA të akuzuara sipas neneve të ndryshme të Kodit Penal

Shpërndarjet e FIPA të gjykuara sipas Nenit 202, paragrafi 2	Shpërndarjet e FIPA të gjykuara sipas Nenit 202, paragrafi 1	Shpërndarjet e FIPA të gjykuara sipas neneve të tjera të Kodit dhe ligjeve
9²²	2²³	17²⁴
	Edhe pse neni 202 është përdorur për t'i gjykuar këto raste, në vend se të gjykohen në bazë të paragrafi 2, ato janë gjykuar bazuar në paragrafin 1, i cili e thekson vetëm incizimin e fotografive intime, dhe jo edhe shpërndarjen e tyre me të tjerët. Në këto 2 raste, fotografitë janë ndarë me të tjerët.	<ul style="list-style-type: none"> - Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike (6 raste); - Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara (5 raste); - Ngacmimi (6 raste); - Hyrja në sistemet kompjuterike (3 raste); - Dhuna në familje (3 raste); - Shantazhi (2 raste); - Ngacmimi seksual (1 rast); - Detyrimi (1 rast); - Tentim shantazhi (1 rast); - Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna Familjare (03/L-182)(1 rast).

Dënimet që u janë dhënë autorëve të krimeve në këto 28 raste ndahen në një rënë nga këto katër kategori: dënim me gjobë, dënim me burgim, dënim unik, dhe dënimi me burgim i zëvendësuar me dënim me gjobë (shih Tabelën 3). Mirëpo, ky hulumtim ka gjetur se vetëm 3 nga 9 dënimet me burgim kanë rezultuar me burgim efektiv, meqë dënimet, që përndryshe ishin me kusht, do të ekzekutoheshin nëse autorët e veprave do ta bënë ndonjë vepër tjetër penale brenda një periudhe të caktuar kohore. Ngjashëm, vetëm 2 nga 9 dënimet unike kanë rezultuar në burgim efektiv; në 3 të tjera, edhe burgimi, edhe gjoba, kanë qenë me kusht, dhe në 4 të tjera, burgimi ka qenë me kusht, ndërsa gjoba jo.

Tabela 3. Dënimet në rastet e shpërndarjes së FIPA, sipas numrit të rasteve

Dënim me gjobë	Dënim me burgim	Dënim unik	Dënim me burgim i zëvendësuar me dënim me gjobë
7²⁵	9²⁶	9²⁷	3²⁸

Në 25 nga 28 rastet e gjykuara për shpërndarje të FIPA, vendimet për dënim kanë marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe/ose rënduese, bazuar në dispozitat relevante të Kodit Penal të Kosovës.²⁹ Në 21 raste janë identifikuar rrethana, edhe lehtësuese, edhe rënduese, ndërkohë që në 4 raste janë identifikuar vetëm rrethana lehtësuese. Mirëpo, nuk ka pasur raste ku janë identifikuar vetëm rrethana rënduese.

22 Numrat e rasteve: 2018:067787, 2018:071422, 2018:063271, P.nr.173/18, 2019:166531, 2019:209803, 2019:084937, 2020:045537, dhe 2022:003671.

23 Numrat e rasteve: 2018:067797 dhe 2022:088189.

24 Numrat e rasteve: 2018:048285, 2018:046896, 2018:067386, 2019:155438, 2019:235747, 2019:116871, 2019:299173, 2019:240487, 2019:291634, 2019:293530, 2019:221265, 2020:097709, 2020:108437, 2021:092275, P.nr. 981/2021, 2021:169715, dhe 2022:136649.

25 Numrat e rasteve: P.nr.173/18, 2018:046896, 2019:221265, 2019:293530, 2019:084937, P.nr.981/2021, dhe 2022:088189.


26 Numrat e rasteve: 2018:071422, 2018:063271, 2019:235747, 2019:291634, 2019:209803, 2020:097709, 2020:045537, 2022:136649, dhe 2022:003671.

27 Numrat e rasteve: 2018:067797, 2018:067386, 2018:048285, 2019:240487, 2019:155438, 2019:116871, 2019:166531, 2019:299173, dhe 2021:169715.

28 Numrat e rasteve: 2018:067787, 2020:108437, dhe 2021:092275.

29 Rrethanat më të shpeshta lehtësuese që janë marrë parasysh në këto aktgjykime ishin: sjellja e mirë, mungesa e regjistrimeve penale, pranimiti i fajësisë, premtimi për të mos kryer krime të tjera, dhe pendimi; rrethanat më të shpeshta rënduese ishin: shkalla e përgjegjësisë penale, shkalla e rrezikut të parashtruar, fuqia e qëllimit, motivet e veçanta, dhe dëmtimi që u është shkaktuar viktimave (d.m.th., shkaktimi i frikës, dhimbjes, torturës, shqetësimit emocional, apo dëmtimi i integritetit personal dhe moral).

Figura 1. Numri i rasteve të shpërndarjes së FIPA në të cilat gjykata gjatë dënimit ka marrë parasysht rrethanat lehtësuese dhe rënduese



Këto gjetje e shpalosin një shkallë të lartë të “dashamirësisë ligjore” në mesin e gjyqtarëve për autorët e veprave kriminale që përfshijnë shpërndarjen e FIPA. Neni 202 e parasheh dënimin nga një (1) deri në tre (3) vjet burg për shpërndarje të paautorizuar të FIPA, por, ashtu siç tregon Tabela 4, niveli i dënimeve të dhëna për këto raste ka anuar qartë kah butësia. Kjo nuk i shërben qëllimit parandalues të dekurajimit dhe parandalimit të autorëve të ardhshëm të këtyre veprave, dhe mund ta nxisë kryerjen e këtyre krimeve nëse kostoja e perceptuar e kryerjes së tyre për autorin e veprës nuk është më e madhe se përfitimi i perceptuar nga ajo.

Tabela 4. Niveli i dënimeve në rastet e shpërndarjes së FIPA

	Dënim me gjobë ³⁰	Dënim me burgim ³¹	Dënim unik ³²	Dënim me burgim i zëvendësuar me dënim me gjobë ³³
Më i ulët	200 €	6 muaj	3 muaj dhe 200 €	30 ditë = 400 €
Më i lartë	1200 €	1.5 vit	1 vit dhe 1200 €	6 muaj = 2000 €

Posedimi i fotografive intime të paautorizuara për qëllime të tjera kriminale

Në rastet që gjykohen si posedim i FIPA për qëllime të tjera kriminale, kryesi i veprës i shfrytëzon FIPA për të kryer shkelje kriminale të tilla si shantazhi, detyrimi, apo ngacmimi i personit të paraqitur në fotografi. Këto raste gjykohen sipas dispozitave të tjera Kodit Penal, meqë ato nuk bijnë nën fushën e nenit 202 të Kodit – i cili e adreson vetëm fotografimin dhe inçizimin e paautorizuar të fotografive, pa bërë dallim midis fotografive intime dhe tipave të tjerë të tyre, dhe nuk i qartëson kërkesat për marrjen e miratimit për t'i inçizuar apo poseduar fotografitë dhe inçizimet që përfshijnë edhe fotografi intime. Bazuar në analizën e aktgjykimeve të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në Kosovë kanë qenë 27 raste që janë në këtë kategori. Prishtina e ka pasur numrin më të madh të këtyre rasteve (8), pasuar nga Prizreni (6 raste), dhe më pastaj nga Peja, Ferizaji dhe Gjakova (nga 3 çdonjëra). Numrin më të vogël të këtyre rasteve e kanë pasur Gjilani dhe Mitrovica (nga 2 raste çdonjëra).

Tabela 5. Aktgjykimet në rastet që kanë përfshirë posedim të FIPA për qëllime të tjera kriminale, sipas vitit

Viti	Numri i Aktgjykimeve
2016	1
2017	2
2018	0
2019	4
2020	6
2021	8
2022	6
Totali	27

30Rastet: 2019:084937 dhe 2018:046896.

31Rastet: 2019:235747 dhe 2020:045537.

32Rastet: 2018:067797 dhe 2019:299173.

33Rastet: 2020:108437 dhe 2021:092275.

Ky hulumtim ka gjetur se në 27 rastet në këtë kategori kanë qenë 27 viktimat dhe 28 autorët e veprave. Përsëri, shumica e këtyre viktimave kanë qenë gra (21), përfshirë edhe një vajzë të mitur; por në këtë kategori, gjashtë nga viktimat kanë qenë burra. Përsëri, gati të gjithë autorët e veprave kanë qenë po ashtu burra (26), me vetëm dy gra të akuzuara për kryerjen e këtyre krimeve. Në 12 raste, viktimat dhe autorët e veprave kanë pasur ndonjë lloj lidhjeje. Në 8 raste, ata kanë pasur lidhje të kaluara; dhe në 4 raste, ata kanë qenë në lidhje në kohën kur është kryer krimi – përfshirë edhe 2 në të cilat viktimat dhe autori i veprës kanë qenë të martuar, si dhe nga një rast ku viktimat dhe autori i veprës kanë qenë duke në lidhje intime.

Motivi i deklaruar i shumicës nga këta autorët e veprave (21) ka qenë përfitimi material. Mirëpo, disa kanë shpresuar se do të ribashkohen me viktimën me të cilën kanë pasur marrëdhënie paraprake (2), ose kanë dashur të krijojnë lidhje me viktimën (2), kanë dashur të vazhdojnë lidhjen me viktimën (1), janë përpjekur ta mbajnë nën kontroll emocional viktimën (1), apo kanë synuar ta detyrojnë viktimën për të kryer akte seksuale me të (1). Në këto 27 raste, gjykatat i kanë dhënë 28 dënime 28 autorëve të krimeve, në formë të dënimit me gjobë, me burgim, dënime unike, dhe të burgimit të zëvendësuar me gjobë. Nga 5 dënimet me burgim për këto vepra, burgu në mënyrë efektive është mbajtur vetëm në 1 rast, meqë 4 të tjerat kanë qenë dënime me kusht. Për më tepër, vetëm 2 nga 15 dënimet e unike kanë qenë dënime me burgim efektive, në 9 raste edhe burgimi edhe gjobat kanë qenë me kusht, ndërsa në 5 raste burgimi (por jo edhe gjobat) ka qenë me kusht.

Tabela 6. Dënimet në rastet e posedimit të FIPA për qëllime të tjera kriminale, sipas numrit të rasteve

Dënim me gjobë	Dënim me burgim	Dënim unik	Dënim me burgim i zëvendësuar me dënim me gjobë
3³⁴	5³⁵	15³⁶	4³⁷

Në 24 nga këto 27 raste, në gjatë gjykimit janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese apo rënduese. Të dy llojet e rrethanave, lehtësuese dhe rënduese, janë identifikuar në 13 raste, ndërsa vetëm rrethana lehtësuese janë identifikuar në 11 raste. Nuk ka qenë asnjë rast i ndërlidhur me posedimin e FIPA në të cilin janë identifikuar vetëm rrethana rënduese.


34 Numri i Rasteve: P.nr.2975/14, P.nr.4660/17, dhe 2019:234703.

35 Numri i Rasteve: 2019:195344, 2019:151671, 2019:219793, 2019:130615, dhe 2020:139384.

36 Numri i Rasteve: P.nr. 1223/2016, 2018:018829, 2018:048989, P.nr.64/18, 2019:190168, 2019:095468, P.nr.37/20, 2020:032012, 2020:171691, 2020:136745, NR2546/20, P.nr.106/17, 2021:051987, 2021:129119, dhe 2021:288879.

37 Numri i Rasteve: 2018:055113, 2019:261332, 2021:256096, dhe 2022:051257.

Figura 2. Numri i rasteve të posedimit të FIPA për qëllime të tjera ku gjykata gjatë dënimit i ka marrë parasysht rrethanat rënduese dhe lehtësuese



Këto gjetje u përngjasojnë atyre të prezantuara në seksionin paraprak, për shpërndarjen e FIPA, dhe përsëri konfirmojnë se gjyqtarët në Kosovë shfaqin një “dashamirësi ligjore” të shquar ndaj autorëve të veprave të keqpërdorimit të FIPA. Niveli i dënimeve në rastet e posedimit të FIPA për qëllime të tjera kriminale është paraqitur në Tabelën 7, dhe e ilustron këtë çështje. Një butësi e tillë ndaj autorëve të krimeve dështon të shërbejë si parandalues për autorët e veprave të ardhshme dhe mund ta inkurajojë kryerjen e këtyre veprave kriminale në të ardhmen.

Tabela 7. Niveli i dënimeve në rastet e posedimit të FIPA për qëllime të tjera kriminale

	Dënim me gjobë ³⁸	Dënim me burgim ³⁹	Dënim unik ⁴⁰	Dënim me burgim i zëvendësuar me dënim me gjobë ⁴¹
Më i ulët	200 €	3 muaj	150 € dhe 60 ditë	6 muaj= 300 €
Më i lartë	500 €	6 muaj	2000 € dhe 1.5 vjet	6 muaj = 2000 €

38Rastet: P.Nr. 4660/17 dhe 2019:234703.

39Rastet: 2020:139384 dhe 2019:130615.

40Rastet: P.nr. 1223/16 dhe 2020:032012.

41Rastet: 2018:055113 dhe 2021:256097.



Kompensimi i viktimave për dëmet emocionale, psikologjike dhe dëmet e tjera

Kur flasim për trajtimin gjyqësor të abuzimeve me FIPA, një nga mangësitë më të mëdha në Kosovë është çështja e kompensimit të viktimave për dëmet emocionale dhe psikologjike të shkaktuara nga vepra penale, dhe për çfarëdo humbje të të ardhurave që viktimat mund ta ketë pësuar apo do ta pësojë si rezultat i veprës penale si dhe nga procedurat e ndërlydhura gjyqësore. Qëllimi i dënimit, në të vërtetë, është që viktimave apo komunitetit t'u jipet kompensimi për humbjet dhe dëmet e shkaktuara nga vepra penale, ashtu siç është përcaktuar në nenin 38 të Kodit Penal. Ndërkaq, neni 59 i Kodit Penal e mundëson shqiptimin e dënimeve plotësuese që kërkojnë nga autorët e krimeve t'i paguajnë këto kompensime. Mirëpo, analizimi i aktgjykimeve që janë shpallur në rastet që përfshijnë FIPA zbulon se pothuajse çdo viktimë ka qenë e udhëzuar që kërkesat për humbjet potenciale t'i ndjekin përmes kontestit civil.⁴² Kjo është një formë e pamjaftueshme e drejtësisë për viktimat, duke marrë parasysh që proceset gjyqësore të karakterit juridiko-civil mund të jenë jashtëzakonisht të gjata, duke u zvarritur për vite të tëra, aq sa disa raste civile në Kosovë nuk e kanë arritur gjykimin përfundimtar madje edhe pas dy dekadave.⁴³

Më tutje, ndërkohë që Indeksi i Sundimit të Ligjit i World Justice Project (WJP) tregon se Kosova e ka bërë një progres të konsiderueshëm në fuqizimin e institucioneve të sundimit të ligjit, me rangimin e tërësishëm në vendin e 57 nga 140 vende dhe juridiksione anembanë botës – duke ia kaluar të gjitha shteteve fqinje, megjithatë rangimi i Kosovës në fushën e drejtësisë civile është dukshëm më i ulët, dhe atë në vendin 84.44 Më në veçanti, është një shkallë e lartë e vonësive të paarsyeshme që Kosovën e shtyn teposhtë në këtë indeks, duke e renditur në vendin e 128 nga 140 vende dhe juridiksione.⁴⁴ Kjo bën që viktimat, të cilat janë të detyruara që të kërkojnë kompensimin përmes proceseve juridiko-civile, të ndjehen të pashpresa.

42 Aneksi 1.

43 Driton Nocaj, *Drejtësia Civile në Kosovë: Ligji vs Praktika* (Prishtinë: IKD, 2019), 4-5.

44 World Justice Project, *WJP Rule of Law Index 2022 [Indeksi i Sundimit të Ligjit i WJP – Projektit të Drejtësisë Botërore]* (Washington, D.C., 2022), 108. Indeksit interaktiv të Sundimit të Ligjit të WJP për vitin 2022 mund t'i qaseni online në: <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/global>.

45 Shih pikët për çdonjërin nën-faktor të peshuar nga WJP në përcaktimin e rangimit të drejtësisë civile, në: <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/factors/2022/Kosovo/Civil%20Justice>.

Si ndikojnë normat shoqërore dhe efektet psikologjike te viktimat e abuzimit me FIPA

Në Kosovë, ku strukturat familjare të ndërlidhura ngushtë dhe përqendrimi në përgjegjësinë dhe nderin kolektiv janë norma, familja dhe komuniteti e kanë një ndikim të konsiderueshëm. Këto norma krijojnë trysni shoqërore për të mbetur konform me standarde të caktuara, dhe shpesh nga një traditë apo të folurit kundër praktikave të dëmshme të komunitetit mund ta shndërrohen në një sfidë, dhe këto janë po ashtu të prirura që gratë t'i vendosin si 'nderi i fytyrës.' Ashtu siç profesoresha Linda Gusia ua shpjegoi hulumtuesve, kjo, në kontekstin shoqëror të Kosovës, don të thotë se rastet që përfshijnë FIPA rëndom perceptohen si dështime të grave që vetë ta ruajnë integritetin e tyre; dhe kjo e bën tejet të vështirë për viktimat që të kërkojnë ndihmë apo madje edhe që ta artikulojnë atë që u ka ndodhur. Dhe, edhe më keq, normat e brendësuar nga këto viktimat bëjnë që ato ta kenë një ndjenjë të fajit dhe të përgjegjësisë për krimet që janë kryer kundër tyre. Gusia vëren se në Kosovë është "një tendencë për ta fajësuar viktimën."⁴⁶

Brenda Kosovës ka komunitete të caktuara ku ndikimi i fuqishëm i interpretimeve konservatore apo fundamentaliste të fesë është manifestuar në norma shoqërore, edhe më të rrepta për gratë. Sipas profesoreshës Gusia, këto praktika fetare zakonisht përkthehen në normat patriarkale ekstreme, duke caktuar role tejet specifike për gratë dhe burrat, dhe duke instrumentalizuar nocionet e stigmatizimit dhe të turpërimit. Në kontekste të tilla, për viktimat e abuzimit me FIPA mund të jetë madje edhe më e vështirë që të kërkojnë drejtësi, sesa që është për gratë në pjesët e tjera të Kosovës, meqë ato mund ta kenë një frikë të arsyeshme se do të përballen me një stigmatizim të konsiderueshëm shoqëror, izolim apo edhe dhunë, nëse flasin. Viktimat mund të përballen me trysni nga vetë familjet dhe komunitetet e tyre që të mbeten të heshtura, apo që çështjen ta zgjidhin privatisht, në vend se të kërkojnë ndihmë nga institucionet e sundimit të ligjit.⁴⁷

Sa i përket temës së miratimit, profesoresha Gusia mbron qëndrimin se qytetarët në Kosovë janë të informuar vetëm deri në një masë të caktuar për këtë koncept, dhe se nuk e kanë brendësuar kuptimin e tij, qoftë në fushën e hulumtimit, në art dhe në kulturë, apo në fushën private. Ajo thekson se abuzimi me FIPA, viktimat e të cilit në masën dërrmuese janë gra, shumë shpesh bën që gratë në Kosovë të jenë viktimat të dyfishta: një herë kur autorët e kryejnë veprën penale, dhe herën e dytë kur femrat përballen me një stigmatizim të konsiderueshëm gjatë raportimit të asaj veprë penale. Sipas pikëpamjes së saj, shumë nga proceset gjyqësore të zhvilluara në vitet e fundit në një përpjekje për t'i adresuar format më të vrazhda të dhunës së bazuar në gjini kanë përfunduar në një dështim total, duke i viktimizuar dhe traumatizuar viktimat sërish. Kjo ndodh meqë sistemi ligjor është thjesht i përbërë nga njerëz që mbahen të lidhur për sistemet e vlerave në të cilët ata janë socializuar.⁴⁸

46 Dr. Linda Gusia, Profesoreshë e Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës, Intervistë nga autorët, 31 janar 2023.

47 Ibid.

48 Ibid.

Aktivisti Arbër Nuhiu po ashtu nënvizoi se koncepti i miratimit në kontekstin e publikimit të informatave private apo të të dhënave personale nuk kuptohet mirë në shoqërinë kosovare, kështu që viktimat të shumta janë të pavetëdijshme që publikimi i paautorizuar i të dhënave apo informatave të tyre është një vepër kriminale.⁴⁹ Në të njëjtën kohë, profesoresha Linda Hoxha vëren se normat shoqërore shpesh herë e kanë fuqinë për të normalizuar sjellje që shkelin hapësirën personale, dhe rrjedhimisht edhe të drejtat individuale, duke i zvogëluar edhe më tepër gjasat që viktimat do t'i raportojnë këto shkelje.⁵⁰ Një argument i ngjashëm është bërë edhe nga Besarta Breznica, nga Rrjeti i Grave të Kosovës, që pohon se natyra patriarkale e shoqërisë kosovare është e tillë që ideja e miratimit neglizhohet në tërësi në shumë nga këto raste. Ajo pretendon se arsyeja pse kryesit e veprave penale, kryejnë vepra të abuzimit me FIPA në Kosovë nuk mendohet kurrë, ndërkohë që përqendrimi është gjithmonë në atë pse viktimat e dërgoi fotografinë në fjalë, apo lejoi veten të inçizohet apo të fotografohet; dhe ndërkohë që kjo përgjegjësi e viktimës është temë e rregullt e diskutimit, shpërndarja e FIPA nuk perceptohet gjerësisht si akt kriminal.⁵¹

Në këto rrethana shoqërore, individë të shumtë që i janë nënshtruar abuzimit me FIPA kanë telashe me atë që të vazhdojnë më tutje. Ata bëhen me një përvojë që e kanë fare pak persona në Kosovë, dhe që mbetet tabu dhe nuk diskutohet. Mirëpo, kjo nuk i mbron viktimat nga ajo që të gjykohen dhe stigmatizohen, nganjëherë edhe në mënyra shumë të vrazhda, dhe ata shpesh herë e kanë tejet të vështirë t'i qasen përkrahjes për të cilën kanë nevojë, madje edhe nga institucionet përkatëse. Prandaj, viktimat të shumta nuk kanë vetëbesim të mjaftueshëm për ta raportuar rastin e tyre, dhe aq më pak për t'u përballuar me proceset hetuese dhe gjyqësore. Për më tepër, ashtu siç shpjegon Breznica, shumë nga zyrtarët policorë, avokatët, zyrtarët e qendrave të punës sociale, prokurorët, dhe gjyqtarët, veprojnë nga një botëkuptim patriarkal që ndikon në zbatimin e ligjit dhe i çon institucionet e drejtësisë dhe të policisë në Kosovë që t'i mbrojnë dhunuesit burra.⁵² Nuhiu, që është pjesë e komunitetit LGBTI+ në Kosovë, pajtohet që kultura dhe tradita e luajnë një rol të rëndësishëm në raportimin e ulët të rasteve në të cilat shkelet privatësia e vajzave dhe grave, meqë janë këto gra ato të cilat paraqiten si "të turpshme," ndërkohë që autorët burra të këtyre veprave nuk paraqiten si të tillë. Dhe vërtetë, Kosova mbetet një shoqëri ku në një masë të madhe ende shihet si jo me vend që një grua të përballlet me një burrë.⁵³

Duke i pasur parasysh këto, Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazinë Gjinore, ka punuar për ta tërhequr vëmendjen në mënyrat në të cilat normat shoqërore mund t'i ndikojnë, edhe institucionet e sundimit të ligjit, edhe viktimat e krimeve që përfshijnë FIPA. Ajo hulumtuesve u theksoi se disa norma të caktuara problematike kulturore vazhdojnë të mbizotërojnë në institucionet që kanë për detyrë t'i trajtojnë këto raste, domethënë, disa njerëz të cilët e kanë për detyrë t'u japin ndihmë viktimave të dhunës marrin qasje thellësisht mizogjene kur janë duke e bërë këtë. Për shembull, Gusia rikujton rastet ku zyrtarët kanë përdorur vetë konceptimin e tyre të ligjit, të tillë si justifikimin e shkeljes së të drejtave të gruas nga ana e partnerit të saj duke u mbështetur në faktin se ata ishin në një lidhje të gjatë. Kur institucioneve u mungon kapaciteti apo kompetenca gjinore për t'u përgjigjur viktimave në mënyrën adekuate, dhe kur normat kulturore veprojnë si pengesë për gratë që kërkojnë qasje në drejtësi dhe shërbimet përkrahëse, disa viktimat pashmangshmërisht do të përballen me një viktimizim për së dyti. Dhe, mbi të gjitha këto, vonesat në proceset gjyqësore shkaktojnë dëme të mëtutjeshme.⁵⁴

Opinionet dhe të dhënat që këta ekspertë ua kanë dhënë hulumtuesve gjatë intervistave janë konfirmuar edhe nga përvojat personale të dy viktimave të krimeve FIPA, ku që të dyjat zgjodhën që abuzimet të mos ua raportnin autoriteteve, por që ishin të gatshme të intervistohen për këtë hulumtim. Njëra viktimë tregoi se ajo ishte detyruar të merrte leje për të munguar për dy muaj nga shkolla për shkak të vështirësive me të cilat u përball, porse ishte tejet e frikësuar që prindërve të saj t'u tregonte se nëpër çfarë ishte duke kaluar. Gjatë kësaj kohe ajo ishte kërcënuar nga shokët

49 Arbër Nuhiu, Aktivist i komunitetit LGBTIQ+, Prishtinë, Intervistë nga autorët, 6 shkurt 2023.

50 Dr. Linda Hoxha, Profesoreshë e Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës, Intervistë nga autorët, 6 shkurt 2023.

51 Besarta Breznica, Rrjeti i Grave të Kosovës, Prishtinë, Intervistë nga autorët, 26 janar 2023.

52 Ibid.

53 Nuhiu, intervistë me autorët.

54 Edi Gusia, Drejtues Ekzekutiv, Agjencia për Barazi Gjinore, Prishtinë, intervistë me autorët, 31 janar 2023.

e klasës që bënin komente seksualisht eksplicite për trupin e saj, dhe kur ajo dhe një shoqe u përpoqën të përballen me individët përgjegjës për shpërndarjen e fotografive të viktimës, ata u përgjigjën në mënyrë shpërfillëse dhe u sollën në mënyrë të papërshtatshme. Si rezultat i kësaj, viktima filloi të brengosej për sigurinë e vet, dhe asaj iu shfaqën edhe probleme të shëndetit mendor. Edhe pse ajo e shqyrtoi mundësinë që incidentin t'ua raportonte institucioneve, ajo në fund vendosi që të mos e bënte këtë, për shkak të mbizotërimit të mentalitetit patriarkal në komunitet dhe meqë nuk kishte besim në institucionet për ligj-zbatuese. Ajo ishte e vetëdijshme për vajza të tjera që kishin raportuar shkelje të ngjashme, dhe për atë se ato nuk kishin pasur trajtim të duhur, gjëra këto të cilat e rrënuan besimin e saj.⁵⁵

Viktima tjetër e keqpërdorimit me FIPA përshkroi se si, pasi që një grup i vajzave të reja e kishin përhapur një fotografi të saj rreth shkollës pa pajtimin e saj, ajo ishte ndjerë e shqetësuar, e ekspozuar, dhe pa kontroll të imazhit dhe reputacionit të saj personal. Frika më e madhe e viktimës ishte që fotoja do të mund të arrinte te prindërit, te anëtarët e familjes, apo te profesorët e saj, dhe se kjo do të mund të ndikonte negativisht në të ardhmen e saj. Me kalimin e kohës, kjo përvojë e pati një efekt të vazhdueshëm në shëndetin e saj mendor, duke u manifestuar në simptoma të përçrregullimit e stresit post-traumatik dhe në probleme të besimit, madje edhe kur nga ajo kërkohet të dilte në fotografi jo-intime. Edhe pse ishte e rrethuar me njerëz që i ofruan dashuri dhe përkrahje, kjo viktimë, po ashtu, për shkak të normave shoqërore mbizotëruese, zgjodhi që incidentin të mos ua raportonte institucioneve. Në retrospektivë, ajo pendohet pse nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim, dhe do të kishte dëshirë sikur ta kishte tejkaluar mungesën e guximit që e kishte ndjerë për t'ua paraqitur rastin e saj.⁵⁶

Edi Gusia e mbron pikëpamjen, që pasojat emocionale të këtij lloji të dhunës psikologjike kanë marrë vëmendje tepër të vogël në Kosovë. Kjo e bën më të vështirë që ky lloj i dhunës të dokumentohet, dhe po ashtu do të thotë se vendi nuk ka kapacitetet njerëzore të nevojshme për t'i hetuar këto krime dhe për ta dhënë një përgjigje adekuate institucionale. Janë disa psikologë klinikë në Kosovë me kompetencë për t'i përkrahur viktimat e këtij lloji të abuzimit.⁵⁷ Megjithatë, profesoresha Hoxha beson se pasojat për viktimat që kanë pasur fotografi, video, apo informata të tjera personale të shpërndara pa miratimin e tyre, mund të jenë serioze dhe me ndikim shumë të gjerë. Dhe paragjykimet, gjykimet, dhe stereotipat që mund të shfaqen në kontekstin e rasteve të abuzimit me FIPA mund ta përkeqësojnë ndikimin në viktima, dhe madje edhe të çojnë në përfundime fatale.⁵⁸

Në këtë kuptim, konteksti shoqëror i përjetuar nga viktimat është vendimtar, meqë ky mund ta rrisë apo ta ulë ndjeshmërinë e tyre ndaj komplikimeve të shëndetit mendor. Në këtë mënyrë, një sistem i fuqishëm i përkrahjes shoqërore e luan një rol të rëndësishëm mbrojtës në këto raste. Ndërkohë që Hoxha vëren se reagimet dhe përvojat e çdo viktime janë unike, dëshmitë shkencore tregojnë mjaft qartë se kërcënimet si ato që rëndom i shoqërojnë abuzimet me FIPA mund t'i kontribuojnë përfundimeve të ndryshme të shëndetit mendor, përfshirë problemet e besimit, të ankthit, depresionit, dhe, në disa raste, edhe formimin e ideve vetëvrasëse. Nëse krimet që përfshijnë FIPA janë po ashtu të lidhura me ndonjë ngjarje traumatike, ato mund të shërbejnë edhe si shtytëse për çrregullimet e stresit post-traumatik.⁵⁹

Për adresimin e mangësive në institucionet kosovare, Edi Gusia propozon të ndërmerret një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj ndërtimit të kapaciteteve, përfshirë edhe përmes aftësimit të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm për zyrtarët policorë, profesionistët ligjorë, dhe gjyqtarët. Ajo beson se po ashtu ka nevojë të aftësohen mësimdhënësit në të gjitha nivelet, meqë ata janë në pozitën më të mirë për t'i frymëzuar nxënësit dhe për t'u angazhuar me ta – si me djemtë, ashtu edhe me vajzat – që nga mosha më e hershme, për t'ju ndihmuar që t'i kuptojnë format e ndryshme

55 Nga intervista me njërën nga viktimat, 1 shkurt 2023.

56 Nga intervista me një viktimë, 2 dhjetor 2022.

57 Edi Gusia, intervistë me autorët.

58 Hoxha, intervistë me autorët.

59 Ibid.

të dhunës dhe të abuzimit. Është e qartë që ky abuzim nuk bën dallime për nga moshën, dhe ka gra të shumta në moshë që nuk janë të përgatitura mirë për ta mbrojtur veten apo për t'u përgjigjur nëse bëhen viktime. Prandaj, sipas Gusisë, është e rëndësishme të qartësohet se ky tip i abuzimit është një formë e dhunës gjinore.⁶⁰

Sido që të jetë, ka fare pak resurse apo programe edukative që aktualisht janë në dispozicion për profesionistët në Kosovë që kërkojnë aftësim për ofrimin e përkrahjes së duhur për viktimat e abuzimit me FIPA, apo të formave të tjera të dhunës gjinore. Profesoresha Linda Gusia sugjeron që e vetmja mënyrë për të intervenuar në sistemet e vlerave seksiste dhe patriarkale në të cilat janë të socializuar shumica e prokurorëve, gjyqtarëve, dhe zyrtarëve policorë të Kosovës është që të imponohen protokolle të rrepta që duhet të ndiqen në të gjitha institucionet e sundimit të ligjit. Ajo argumenton që këto protokolle duhet të përpilohen përmes një procesi që merr parasysh thellësisht kontekstin shoqëror si dhe duhet të përfshijë komentet e ekspertëve dhe të palëve të interesuara. Për më tepër, ajo beson që dënimet për krimet që përfshijnë FIPA duhet të jenë më të rrepta, duke pasur parasysh ndikimin shkatërrues që këto vepra penale mund të kenë në viktimat e tyre.⁶¹

60 Ibid.

61 Linda Gusia, intervistë me autorët.

Konkluzionet dhe rekomandimet

▮▮ **Si rezultat, në Kosovë, sipas nenit 202 janë ngritur aktakuza vetëm për një të tretën e rasteve që përfshijnë shpërndarjen e FIPA, ndërkohë që në rastet e tjera janë zbatuar akuza më të lehta. Një mungesë domethënëse në Kodin Penal të Kosovës është që ky nuk e trajton posedimin e paautorizuar të fotografive personale, përfshirë edhe ato intime** ▮▮

Ashtu siç ka treguar ky hulumtim, Kodit Penal të Kosovës i mungojnë dispozitat që në mënyrë të qartë i kriminalizojnë abuzimet që kanë të bëjnë me FIPA, gjë që e pengon raportimin, hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave. Ndërkohë që neni 202 i Kodit e adreson, në një aspekt të përgjithshëm, fotografimin, inçizimin dhe shpërndarjen e fotografive, megjithatë nuk e përcakton se çfarë do të thotë të merret, të refuzohet, apo të ndërpritet autorizimi (d.m.th. miratimi). Si rezultat, në Kosovë, sipas nenit 202 janë ngritur aktakuza vetëm për një të tretën e rasteve që përfshijnë shpërndarjen e FIPA, ndërkohë që në rastet e tjera janë zbatuar akuza më të lehta. Një mungesë domethënëse në Kodin Penal të Kosovës është që ky nuk e trajton posedimin e paautorizuar të fotografive personale, përfshirë edhe ato intime. Në 27 rastet e posedimit të paautorizuar të FIPA që janë gjykuar në Kosovë, fotografite intime janë shfrytëzuar për

qëllime kriminale, përfshirë shantazhin, detyrimin, apo ngacmimin, krime këto që dalin jashtë fushës së paragrafit 1 të nenit 202.

Gjetjet e këtij hulumtimi po ashtu e vejnë në dukje një butësi të konsiderueshme të shfaqur nga gjyqtarët në Kosovë ndaj autorëve të veprave të abuzimit me FIPA, shumica dërrmuese e të cilëve janë burra. Në raste të shumta, rrethanat lehtësuese janë zbatuar për uljen e dënimeve apo për zëvendësimin e tyre me gjoba. Në të njëjtën kohë, përpjekjet e viktimave për të siguruar kompensime adekuate për dëmet emocionale, psikologjike, dhe dëme të tjera, të cilat i kanë pësuar si rezultat i këtyre krimeve, paraqesin një sfidë që zhvillohet në një terren të vështirë. Edhe pse Kodi Penal parasheh që kompensimi t'u paguhet viktimave dhe që dënimet shtesë mund të kërkojnë nga një autor i dënuar i veprës që ta paguaj këtë kompensim, viktimat në një mënyrë tipike drejtohen nga autoritetet që kërkesat për dëmtimet potenciale t'i ndjekin përmes proceseve gjyqësore civile – procese këto që mund të jetë jashtëzakonisht të gjata, duke zgjatur me vite apo madje edhe me dekada.

Ky hulumtim është forcuar nga këndvështrimet e ekspertëve të ndryshëm, ku të gjithë këta e diskutuan rolin që normat shoqërore patriarkale e luajnë në kontekstin e abuzimeve me FIPA. Këto norma autorëve të veprave ju ofrojnë një ndjenjë të pandëshkueshmërisë apo të fuqisë, dhe kanë efekte të thella në përvojën e viktimave, të cilat shpesh herë e kanë ndjenjën e fajit apo të turpit që i kanë "lejuar vetes" të bëhen viktimat. Këto ndjenja vetëm që rriten më tutje nga trajtimi që viktimat shpesh herë e kanë nga zyrtarët në institucionet e sundimit të ligjit, e të cilët po ashtu i pranojnë këto norma mbizotëruese. Kjo viktimat i lë që të përballen me paragjykimet e atyre që e kanë për detyrë t'i përkrahin dhe të sigurojnë që drejtësia të kryhet në emër të tyre; dhe kjo është një formë e viktimizimit të serishëm, që viktimat e tjera i dekurajon për t'i raportuar këto vepra. Ekspertët kanë vërejtur që normat shoqërore në Kosovë po ashtu i frymëzojnë mënyrat në të cilat njerëzit e konceptualizojnë

miratimin në marrëdhëniet private, duke e rritur një mjedis të butë dhe lejues për autorët potencial të krimeve që përfshijnë FIPA. Edhe përkundrejt kësaj butësie për autorët e veprave, ashtu siç e demonstroi ky hulumtim, shpërndarja dhe posedimi i paautorizuar i FIPA mund të ketë pasoja të rënda për viktimat, që shtrihen nga pasojat sociale, të tilla si stigmatizimi dhe stereotipizimi, e deri te pasojat për shëndetin mendor, të tilla si ankthi, depresioni, dhe në disa raste, edhe te mendimet për vetëvrasje.

Në këtë mënyrë, duke u bazuar në gjetjet e këtij hulumtimi dhe në dispozitat e Konventës së Stambollit, palët e interesuara relevante në Kosovë duhet ta marrin parasysh zbatimin e masave në vijim:

- Të parashihet një vepër penale e veçantë për fotografitë intime të paautorizuara (FIPA): Kodi Penal i Kosovës duhet të amendamentohet për t'i kriminalizuar veprimet e ndryshme që përfshijnë FIPA dhe për ta lehtësuar raportimin, hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve.
- Të nisen fushata të edukimit dhe për ngritjen e vetëdijes: Fushatat për ngritjen e vetëdijes publike duhet të jenë të organizuara për ta edukuar publikun, dhe posaçërisht të rinjtë, për rreziqet e FIPA dhe për dëmet që abuzimi me FIPA u shkakton viktimave, dhe duhet të synojnë që njëkohësisht t'i luftojnë normat patriarkale dhe objektifikimin e grave dhe të vajzave.
- Të sigurohet që procedurat dhe vendimet gjyqësore në rastet që përfshijnë FIPA t'u përmbahen dispozitave të Kodit Penal dhe të Konventës së Stambollit: Gjykata duhet t'i trajtojë krimet e ndërlidhura me FIPA me seriozitet dhe duhet që autorët e veprave t'i konsiderojë si plotësisht llogaridhënës për veprimet e tyre, dhe prandaj duhet të përmbahet nga aplikimi i rrethanave lehtësuese për t'i ulur dënimet apo për t'i zëvendësuar ato me gjoba – gjë kjo që autorëve të këtyre veprave u dërgon një mesazh që këto krime nuk konsiderohen si serioze – dhe që në vend të kësaj të japin dënime më të rënda të cilat individët do t'i parandalonin nga kryerja e këtyre krimeve në të ardhmen.
- Trajnimi i zyrtarëve policorë dhe zyrtarëve gjyqësorë: Zyrtarëve policorë dhe gjyqësorë duhet t'u jepet aftësim i specializuar për t'ju ndihmuar që t'i identifikojnë dhe të merren me rastet që përfshijnë FIPA, me një përqendrim në konsideratat legale dhe etike të përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre rasteve, si dhe për t'i njoftuar me praktikën më të mira për ofrimin e përkrahjes së duhur për viktimat.
- Trajnimi i gjyqtarëve: Është shumë e rëndësishme që të ngritet vetëdija në mesin e gjyqtarëve për çështjen e abuzimit me FIPA dhe për ndikimin në viktimat, si dhe për ta sensibilizuar gjyqtarët për faktin që këto viktima mund të bëhen sërish viktima me butësinë që shfaqet ndaj kryerësve të këtyre veprave.
- Të themelohen shërbimet për përkrahjen e viktimave: Të gjitha viktimat e abuzimeve me FIPA duhet të kenë qasje në shërbimet për përkrahjen e viktimave që ofrojnë resurse emocionale dhe psikologjike si dhe u ndihmojnë viktimave t'i qasen ndihmës juridike.
- Të forcohen dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kompensimin e viktimave. Kodi Penal i Kosovës duhet të forcohet për ta siguruar kompensimin e viktimave të krimeve që përfshijnë FIPA, përfshirë këtu masat që viktimave u sigurojnë që të kompensohen edhe për dëmet materiale dhe jo-materiale.

Aneksi 1. Aktgjykimet në rastet që përfshijnë FIPA që janë të publikuara në bazën e të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Shpërndarja e FIPA

Numri i rastit	Data e aktgjykimit
2018:048285	19.11.2018
2018:071422	01.10.2019
P.nr.173/18	15.02.2019
2018:046896	21.02.2019
2018:067386	07.02.2019
2018:067797	16.09.2019
2018:067787	24.09.2019
2019:209803	13.11.2019
2019:155438	18.11.2019
2019:235747	28.11.2019
2019:116871	24.12.2019
2019:299173	04.02.2020
2019:084937	21.04.2020
2019:240487	06.03.2020
2020:097709	09.09.2020
2019:291634	11.01.2020
2020:045537	01.03.2021
2020:108437	04.08.2021
2021:092275	18.06.2021
2019:293530	07.07.2021
P.nr. 981/2021	15.12.2021
2022:136649	03.08.2022
2022:003671	23.03.2022
2022:088189	23.05.2022
2021:169715	25.05.2022
2019:166531	08.04.2022
2019:221265	11.02.2022
2018:063271	19.09.2019

Posedimi i FIPA

Numri i rastit	Data e aktgjykimit
2020:136745	06.04.2022
2019:095468	26.11.2020
2021:288879	15.07.2022
2022:051257	29.04.2022
2019:195344	16.03.2020
P.nr. 64/18	20.05.2019
P.nr. 1223/16	18.10.2016
2018:048989	25.06.2019
P.nr. 37/20	09.03.2020
2019:261332	10.07.2020
2018:018829	01.07.2019
2020:139384	23.03.2021
P.nr. 2975/14	07.09.2017
P.nr. 4660/17	20.12.2017
P.nr. 106/17	22.10.2021
2019:151671	17.08.2021
2019:234703	24.02.2020
2020:171691	26.01.2022
2019:219793	06.11.2020
2020:032012	10.11.2021
NR 2546/20	22.04.2021
2018:055113	26.02.2021
2019:130615	14.12.2021
2019:190168	25.10.2019
2021:129119	28.06.2022
2021:256097	13.12.2021
2021:051987	24.05.2022

Bibliografia

Council of Europe. Convention on preventing and combating violence against Women and domestic violence [Këshilli i Evropës. Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës familjare], CETS 210, 11 maj 2005.

European Institute for Gender Equality. *Combating Cyber Violence against Women and Girls*. [Instituti Evropian për Barazi Gjinore. *Luftimi i Dhunës Kibernetike kundër Grave dhe Vajzave*], Vilnius, 2022.

European Institute for Gender Equality. "Cyber Violence against Women and Girls: Key Terms and Concepts," [Instituti Evropian për Barazi Gjinore. "Dhuna Kibernetike kundër Grave dhe Vajzave: Shprehje dhe Koncepte Kyçe"] 2022.

Government of Ireland. Harassment, Harmful Communications and Related Offences Act 2020 [Qeveria e Irlandës. Akti i vitit 2020 për Ngacmime, Komunikimin Dëmtues dhe Veprat Penale të Ndërlidhura]. Irish Status Book [Libri Irlandez i Statusit] No. 32 i 2020, 28 dhjetor 2020.

Government of Kosovo. Constitution of the Republic of Kosovo [Qeveria e Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës], 15 qershor 2008.

Government of Kosovo. Criminal Code of the Republic of Kosovo [Qeveria e Kosovës. Kodi Penal i Republikës së Kosovës]. Official Gazette of the Republic of Kosovo [Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës], No. 06/L-074, 14 janar.

Government of Kosovo. Law on Protection of Personal Data [Qeveria e Kosovës: Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale]. Official Gazette of the Republic of Kosovo [Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës], No. 06/L-082, 25 shkurt 2019.

Henry, Nicola, et al. *Image-Based Sexual Abuse: A Study on the Causes and Consequences of Non-Consensual Nude or Sexual Imagery* [Abuzimi Seksual i Bazuar në Fotografji: Studim për Shkaqet dhe Pasojat e Fotografive të Paautorizuara Seksuale dhe të Lakuriqara]. Routledge, 2021.

Karasava, Vaslieia. "Personality, Attitudinal, and Demographic Predictors of Non-consensual Dissemination of Intimate Images." ["Parashikuesit e Personalitetit, të Qëndrimit, dhe ata Demografikë të Përhapjes së Paautorizuar të Fotografive Intime."] *Journal of Interpersonal Violence* 37, no. 22-23 (2021): NP19265–NP19289.

Nocaj, Driton. *Drejtësia Civile në Kosovë: Ligji vs Praktika*. Prishtinë: IKD, 2019.

Sali, Meghan. "Intimate Images and Authors' Rights: Non-Consensual Disclosure and the Copyright Disconnect." ["Fotografite Intime dhe të Drejtat e Autorit: Zbulimi i Paautorizuar dhe Shkëputja nga e Drejta e Autorit."] *Canadian Journal of Law and Technology* 19, no.2(2022): 333–369.

UNICEF. "Defining Social Norms and Related Concepts." ["Përcaktimi i Normave Shoqërore dhe i Koncepteve të Ndërlidhura."] nëntor 2021.

World Justice Project. *WJP Rule of Law Index 2022*. [Projekti i Drejtësisë Botërore. *Indeksi i Sundimit të Ligjit i PDB për 2022*] Washington, D.C., 2022.

